



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 224/2023

Datë: 15/12/2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 34 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar nën 3 dhe 4 të Rregullores MD - nr. 06/2023 për procedurën e ankesave për ndihmë juridike falas, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj çdo vendimi të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në këtë përbërje:
 - 1.1. Flamur Hyseni, Kryetar, Fakulteti Juridik/UP;
 - 1.2. Diellza Mujaj, anëtare, Departamenti Ligjor/MD; dhe
 - 1.3. Lirika Bakija, anëtare, Shoqëria Civile.
2. Mandati i anëtarëve të Komisionit nga pika një (1) e këtij vendimi është tre (3) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.
3. Obligohen anëtarët e Komisionit sipas pikës 1 të këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ti kryejnë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albulena HAXHIU
Ministër e Drejtësisë



Vendimi i u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit.
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa/MD;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore/MD;
- Arkivit të MD-së.